

STATUT
I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

Innovative Marketing Solutions

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- “Statuti” është Statuti i Shoqërisë;
- “Ditë të Plota” në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.
- Shumicë absolute janë ortakët që zotërojnë më shumë se 75% të kapitalit të Shoqërisë.
- Shumicë e thjeshtë janë ortakët që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të Shoqërisë.
- Termi Ortaku i Vetem nenkupton edhe Asamblene e Përgjithshme të Ortakeve apo anasjelltas, me qëllim që të jete i qarte edhe nëse shtohen ortakë të tjerë në Shoqëri, derisa Asambleja e re të mos kërkojë ndryshimin e Statutit.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe Adresa e Faqes së Internetit (nëse ka)

Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më 17.01.2021 në themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin e subjektit **Innovative Marketing Solutions sh.p.k** dhe emrin tregtar **I.M.S.**
2. Themeluesi i shoqërisë është :
 - **Fitim Harrun HOXHA**

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

I. Shërbime Marketingu, telemarketingu, teleselling me shërbime Call Center apo Contact Center si Outbound (telefonata në dalje), Inbound (telefonata në ardhje), Customer Service (asistencë klientesh), Help Desk (suport teknik), numra të gjelbër, kërkimet e tregut, sondazhe, mesazhe promovionale etj.

II. Përgatitje, krijim (web design) implementim dhe mirëmbajtje faqe interneti, ofrim domain, shërbim ëcb hosting, programe kompjuterike (softëare), aplikacione në të gjitha platformat për ëeb, desktop, mobile etj, menaxhim i rrjeteve sociale, realizimin e fushatave reklamuese etj.



Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e papercaktuar.

Neni 4: Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Bashkiake Nr.5, Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake Nr.55/1, Tirane.

**Kreu II
Kapitali i Regjistruar**

Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë.
2. Pjesëmarrja e ortakut te vetem në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtëm:

- **Fitim HOXHA:** pjesëmarrja në përqindje 100 %, 1 kuotë, lloji i kontributit para, 100.000 (njëqind mijë) Leke, kontribut i cili është paguar plotësisht dhe menjëherë.

Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

1. Administratori mund t'i kërkojë ortakut egzistues ose të rinj të Shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhtëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
2. Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.
3. Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori mund të njoftojnë paraprakisht të paktën katërbëdhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumën e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarimin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.
4. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorit dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumën e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.



5. Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratori konsideron të përshtatshme.
6. Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë personalisht përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

Neni 7: Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë absolute.

Neni 8: Certifikatat e kuotave

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave.

Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9: Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- shitblerjes;
- dhurimit;
- trashëgimisë;

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Në çdo rast, për shitjen e çdo kuote është e detyrueshme miratimi i shoqërisë me vendim të shumicës absolute. Nga ky rregull nuk bëjnë përjashtim personat me lidhje familjare dhe çdo tjetër.

- Në rastet kur një ortak kërkon që t'i shesë kuotat e tij tek një tjetër duhet në çdo rast miratimi i me shkrim i ortakëve të tjerë. Ortakët egzistues kanë të drejtën e parablerjes së kuotave të ortakut që largohet duke u bazuar në çmimin e kuotës sipas kapitalit themeltar të deklaruar prej shoqërisë. Ushtrimi i të drejtës së parablerjes do të mundësohet në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të njoftuar rregullisht.
- I njëjti rregull vlen edhe për dhurimin. Në çdo rast shumica e absolute do të japë miratimin për dhurimin e aksioneve.
- Në këtë rregull bën përjashtim trashëgimia ligjore e vërtetuar sipas legjislacionit në fuqi.



- Në çdo rast ortaku i ri që do të vijë në të ardhmen ka detyrim të pranojë këtë statut, deri sa ai të ndryshohet, sipas kushteve të parashikuara në këtë statut.

Neni 10: Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Ortaku i vetem ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me shumicë absolute, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur vlerën e kuotave të ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Gjithashtu shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Ortakut të vetem apo Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën absolute.
2. Nga Ortaku i Vetem apo Asambleja e Përgjithshme, me shumicë absolute të votave të ortakëve, do të miratohet edhe zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri.

Neni 11: Blerja e Kuotave të Veta

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre (jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja) vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve dhe Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen.

Kreu III Asambleja e Përgjithshme

Neni 12: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Administratori thërret Asamblesë të Përgjithshme edhe me kërkesën e ortakëve (që përfaqësojnë jo më pak se 5% të kuotave), do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe do t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë të plota përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
3. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje (nëse shoqëria ka mundësuar një të tillë).
4. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse shumica absolute është dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 13: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme



1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar për çdo rast. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që i'u është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratori cakton Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
3. Nëse asnjë nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej tyre nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm me të drejtë vote, me shumicë të thjeshtë, zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
4. Administratori, edhe nëse nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
6. Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:
 - i. Kryetari; ose
 - ii. Një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku.
7. Deklarimi i Kryetarit dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes se :
 - i. vendimi është marre në mënyrë unanime, ose
 - ii. me një shumicë të caktuar, ose
 - iii. nuk është miratuar apo nuk është miratuar me një shumicë të caktuar
 përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
8. Në rast se ka kundërshtime nga ortakët për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 14: Votat e Ortakëve

1. Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep të drejtën e një vote:



- i. ortakut të pranishëm (në rastin kur është individ) apo përfaqësuesit të autorizuar prej tij ose
 - ii. ortakut (ne rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt.
2. Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do t'i komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.
 3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Neni 15: Votimi me Prokurë

1. Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku (individ apo person juridik) sipas formës së mëposhtme (ose në formën që mund te miratohet nga Administratori):

“Innovative Marketing Solutions SHPK”

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, ne cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më, ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më, dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më.....”.

2. Në rastet kur ortakët do ta përcaktojnë vete votimin për ceshtjen/et konkrete, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën që mund te miratohet nga Administratori):

“Innovative Marketing Solutions SHPK”

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, ne cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më, ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më, dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Vota është si më poshtë :

Vendimi Nr. 1, në lidhje me : *pro *kundër

Vendimi Nr. 2, në lidhje me : *pro *kundër.

(*do të fshihet zgjedhja e padëshiruar).

Përveç udhezimeve të mësipërme, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme.

Nënshkruar më.....”.



3. Emërimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori, depozitohet :
 - i. në selinë e shoqërisë ose
 - ii. në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ose
 - iii. në adresën e degës apo zyrës së përfaqësimit të shoqërisë ku do të kryhet mbledhja,siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
4. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.
5. Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) sipas përcaktimeve të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 16 Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme me shumicë të absolute, merr vendim për:
 - i. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - ii. shuarjen apo faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - iii. ngritjen e një padie ndaj tij prej shoqërisë;
 - iv. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, edhe i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 17: Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

KREU IV Administratori

Neni 18: Emërimi i Administratorit

1. Asambleja e përgjithshme, me shumicë absolute, emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 4 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
2. Nëse shoqëria do të jetë shoqëri tregtare mëmë, administratorët nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Administratori i shoqërisë, mund të emërohet si administrator të një dege apo zyre përfaqësie të shoqërisë.



4. Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë me afat nga data 17.01.2021 deri më 16.01.2025.

Të dhënat e identifikimit:

Fitim Harrun HOXHA

dhe specimeni i nënshkrimit:

Neni 19: Kompetencat e Administratorit/eve

Administratoret kane të drejtë dhe detyrohen të:

1. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Bisnesit;
7. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
 - i. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - ii. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër, aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - iii. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
10. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të thjeshtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 20:

Përfaqësimi

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të nje administratori i kundërdrejtohen palëve të treta. Në çdo rast është përgjegjësi e administratorit që në takime apo marrëveshje me palë të treta të dorezojë ekstratin e Rregjistrimit Tregtar me të dhënat e Shoqërisë.
2. Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë një apo disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet që i drejtohen secilit prej administratorëve janë të vlefshme dhe detyruese për shoqërinë.
3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
4. Administratorët mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosin Administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

Neni 21: Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. shkarkohet nga detyra ;
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese, në rastet e dëmshpërblimit dhe jo vetëm;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë jo më pak se 30 ditë përpara.

Neni 22: Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorëve

1. Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Ortaku i Vetem apo Asambleja e Përgjithshme.
2. Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për :
 - i. çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, ne shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose ne shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese apo të filialeve të saj,
 - ii. për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre.
3. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme.
4. Administratorëve mund t'iu paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorëve ose të komiteteve të Administratorëve ose të Asamblesë së Përgjithshme si edhe ne levizjet drejt/per filialet e shoqërisë, në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

Neni 23: Mbledhjet e Administratorëve

1. Mbledhjet e Administratorëve do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.

2. Asambleja e Përgjithshme cakton njërin prej Administratorëve me detyrën e Kryetarit të mbledhjes së Administratorëve, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo mbledhje të Administratorëve në të cilat ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratorët e pranishëm mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
3. Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
4. Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorëve, ose nga një komitet i Administratorëve, apo nga persona të cilët veprojnë si Administratorë, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një Administratori ose njëri prej tyre ka qenë i skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administratorë dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.
5. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Administratorëve ose nga komiteti i Administratorëve do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëjloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Administratorëve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

Neni 24: Kufizimet në Votimet e Administratorëve

1. Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:
 - i. të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
 - ii. të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.
2. Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
3. Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë.
4. Në rast se në mbledhjen e Administratorëve ose të komitetit të Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një Administratori, çështja mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 25: Procesverbalet e Mbledhjeve të Administratorëve

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

1. të gjitha takimeve të kryera nga Administratorët; dhe

2. të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve të Administratorëve dhe komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

KREU V

Degët dhe zyrat e përfaqësimit

Neni 26: Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit

1. Shoqëria ka të drejtë të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda apo jashtë shtetit. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e tyre.
2. Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete si dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.
3. Zyrat e përfaqësimit janë vende të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Zyrat e përfaqësimit nuk kanë si qëllim krijimin e të ardhurave, por nxitjen e veprimtarisë së shoqërisë. Këto zyra mund të lidhin marrëveshje në emër e për llogari të saj.
4. Nëse degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërisë krijojnë faqe interneti, ato duhet të publikojnë numrin unik të identifikimit të shoqërisë në këtë faqe interneti.
5. Dega vepron nën emrin e regjistruar të shoqërisë, si dhe nën emrin e saj.
6. Përfaqësuesi i degës apo zyrës së përfaqësimit, emërohet me shumicë të thjeshtë të asamblesë së ortakëve, i cili sipas rastit mund të jetë administratori i shoqërisë dhe/ose një person tjetër.

Neni 27 : Funkionimi i degeve dhe zyrave të përfaqësimit

1. Administratori i shoqërisë, administron punën dhe aktivitetin e degës apo zyrës së përfaqësimit.
2. Sipas rastit shoqëria mund të dërgojë të punojë në degë apo zyra përfaqësimi, stafin e vet të punësuar në Shqipëri ose mund të punësojë staf në vendin ku ushtrohet aktiviteti.

Kreu VI

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 28: Dividendët

1. Pas plotësimit të detyrimeve ligjore dhe deklarimit nga administratorët për aftësinë paguese, shoqëria me shumicë absolute të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
2. Dividendët do të deklarohen dhe paguhen në përputhje me kuotat e zotëruara prej secilit ortak. Në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.



3. Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
4. Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të cilësuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 29: Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë absolute votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Kreu VII Prishja dhe njoftimet

Neni 30: Prishja dhe likuidimi

Shoqëria do të priset:

1. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
2. me vendim të Ortakut të Vetem apo shumicës absolute të asamblesë së përgjithshme;
3. me hapjen e procedurave të falimentimit;
4. me vendim të gjykatës;
5. për arsye të tjera, të parashikuara në statut
6. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Neni 31: Ndarja apo bashkimi me përthithje

1. Shoqëria mund të transformohet me ndarje apo mund të bashkohet me përthithje me shoqëri të tjera tregtare.
2. Për këtë rast do të vendosin ortakët që kanë shumicën absolute të kapitalit të shoqërisë.

Neni 32: Njoftimet


1. Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë



- qëllim dhe personin që kryen njoftimin. Njoftimi elektronik do të merret i mirëqënë me çdo email me të cilin është përgjigjur të paktën një herë administratori i shoqërisë.
2. Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët.
 3. Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).
 4. Për ato që nuk parashikohen në këtë statut do të referohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Vetëm

Fitim HOXHA

The image shows a handwritten signature in blue ink. The signature is written in a cursive style and appears to read 'Fitim Hoxha'. Below the signature, there is a horizontal line that has been crossed out.